



KOMUNA KALLMET

KALLMET MUNICIPALITY

TRADITE, HISTORI DHE KULTURE

tradition, history and culture



100 Vjet Pavaresi



KOMUNA KALLMET
KALLMET MUNICIPALITY
TRADITE, HISTORI DHE KULTURE
tradition, history and culture

PERMBLODHI / SUMMERIZED

EVARISTO COLI

VITORE GJEKAJ

REDAKTOR / EDITOR

GJOVALIN GJELOSHI

PERKTHYES / TRANSLATOR

SONILA MARKU


BRIKENA MARKU

PERGATITJA GRAFIKE / GRAPHIC DESIGN

EVARISTO COLI

FOTOGRAFITE / PHOTOS

ARKIVA E KOMUNES KALLMET, ARKIVA E FAMULLISE KALLMET



Të nderuar miq dhe vizitorë të komunës Kallmet. Dëshirojmë që me anë të këtij materiali t'iu sjellim informacione mjaft të rëndësishme për komunën Kallmet, si një trevë e rëndësishme jo vetëm për qarkun e Lezhës, por për të gjithë Veriun e Shqipërisë, ku ndërthuren historia, trashëgimia kulturore, fetare dhe etnografike, zhvillimi ekonomik dhe vizioni për të ardhmen.

Komuna Kallmet ndodhet në një moment mjaft të rëndësishëm historik të zhvillimit të saj. Falë investimeve publike të realizuara edhe nga investimet qeveritare e joqeveritare si dhe nga vetë banorët e komunës Kallmet (veçanërisht emigrantët) kanë bërë të mundur një zhvillim rural të qëndrueshëm të kësaj treve në kuadër të zhvillimit kombëtar si dhe integritit të Shqipërisë në BE.

Dear friends and guests of Kallmet Municipality. We aim through this material to give you key informations and brief description of municipality as a very important territory not only of the district of Lezha but of the whole northern Albania where the history, cultural, religious and ethnographic heritage, as well as the vision for the future, are combined.

The Municipality of Kallmet come to pass a very important historic moment of its development. Thanks to public investments achieved from Municipality of Kallmet, supported by governmental investments and those ungovernmental, as well as the investments made by inhabitants of the municipality (especially immigrants) have made possible a sustainable rural development of this territory within the national development, as well as the integration of Albania in EU.


Kryetari/Mayor

Petrit Marku

TE DHENA TE PERGJITHSHME

Komuna Kallmet shtrihet në pjesën veri-perëndimore të qarkut të Lezhës. Ajo është e vendosur në aksin e rrugës Lezhë - Vau Dejës duke siguruar një vendndodhje të mirë gjeografike në pikëpamjen e ndërlidhjes dhe aksesit në infrastrukturë mes qarqeve Shkodër dhe Lezhë. Popullsia e komunës Kallmet është mbi 7000 banorë, e shpërndarë kjo në 4 fshatrat: Kallmet i Madh, Kallmet i Vogël, Rraboshtë dhe Mërqi .


Aktivitetet kryesore ekonomike të kësaj komunë janë të përqëndruara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, me fokus vreshtarinë dhe pemtarinë si dhe prodhimtarinë e vajit të ullirit. Komuna është e njohur për prodhimin e verës vendase të Kallmetit si dhe vajit të ullirit karakteristik të kësaj zone, duke mbajtur kështu një status të cilin e trashëgon që përpara viteve '90. Komuna Kallmet administron një sipërfaqe prej 4306 ha nga të cilat 1875 ha është tokë bujqësore dhe pjesa tjetër pyje dhe kullota. Komuna është e pasur në burime natyrore, historike dhe sidomos kulturore çka krijon premisa të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të saj në drejtim të turizmit historik dhe kulturor, por dhe të agro-turizmit, përpos zhvillimit bujqësor si degë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik vendor.



Pamje Satelitore e Komunës Kallmet
Satelit view of Kallmet municipality

GENERAL INFORMATION

QARKU LEZHE - DISTRICT OF LEZHE



Municipality of Kallmet lies in the north-western part of the district of Lezha. It is located in the highway Lezhe - Vau Dejes providing, a good geographical position in the view of proposed interconnection and access to infrastructure between districts like Shkoder and Lezha. The population of the Municipality of Kallmet is over 7000 inhabitants, spread in four villages: Great Kallmet, Little Kallmet, Rraboshte and Merqi.

The main economic activities of this municipality are those concentrated on the field of agriculture and livestock, focusing on viticulture and orchards, as well as the production activity of olive oil. Municipality is wellknown for the production of the local vine Kallmet, as well as of the olive oil typical of this area, holding in this way a status inherited since before the 90's. Kallmet Municipality administrates an area of 4306 ha, 1875 ha of which is agricultural land and the rest forests and pastures. The municipality is within natural, historic and overall cultural resources, what provides the premises for the further development of its historic and cultural tourism except the agricultural development as a animportant branch of the local economic development.

HISTORIA - HISTORY

Picture of cemetery

Foto e varrezes



Yers old.

Ulli mbi 1500 vjecar
Olive tree over 1500

Një gojëdhanë e vjetër thotë se dikur ky fshat ishte i mbuluar nga uji, i cili duke u pakësuar la pas lym e baltë që ndikoi në rritjen e kallamit të egër, bimë kjo që i dha këtij vendi emrin Kallmet (Kallam meti = Kall-meti). Kallmeti është një vendbanim i lashtë. Gjetjet arkeologjike në të gjithë shtrirjen e fshatit tregojnë se këtu është banuar që nga periudha e gurit të ri (Neolitit) e deri në antikitetin e vonë .

Edhe pas pushtimit romak popullsia vazhdoi të banojë këtu dhe krijoi kulturën e saj të veçantë.

Këtë e dëshmon varreza mesjetare e gjetur tek ullishta e Gjek Simonit (shekulli 6-8 e.s.). Vazhdimësia e jetës se këtyre banorëve në Kallmet nuk u ndërpre: ata krijuan kulturën e tyre, kristalizuan tiparet dalluese duke e bërë këtë fshat një njësi etnografike të veçantë në rrethin e Lezhës. Dalluese është veçanërisht veshja e grave dhe e vajzave me rroba krejt të bardha (vazhduese e veshjes ilire).

According to old tradition, once upon a time this village was full of water, which by shrinking and diminishing its level, left behind only silt and clay that influenced and brought about the growth of cane, the plant that gave the name Kallmet. Kallmet is an ancient settlement.


The archeological findings in all the extent of village show that it has been habitable since the new stone age era up to the late Antiquity.

Even after the roman invasion people continued to live here and shaped their own culture. The medieval graves found in olive groves of Gjek Simoni (6-8 centuries B.C.) testifies this. The continuity of life of these inhabitants in Kallmet never discontinued, they created their own culture with characteristic features distinguished from the others making this one, a special ethnographic unit in the traditional wearing of women and girls with completely white clothes (considered as sequentil of Illirian dressing).

Kallmetorët janë bujq dhe vreshtarë të mirë. Në Kallmet kultivohen varieteti i rrushit “Kallmet”, fasulja me emrin “Kallmet” dhe ulliri kokërr madh që përmendet në literaturën shkencore bujqësore. Në Kallmet janë ngritur monumente të kultures si Kisha e Shën Eufemisë e shekullit 13-të e cila është një vend i shenjtë ku vijnë besimtarë nga të gjitha krahinat. Kjo kishë është në listën e monumenteve të kulturës që gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti. Komuna Kallmet shquhet si qendër e rëndësishme historike, kulturore dhe fetare.

Inhabitants of Kallmet are good farmers and tenants, they cultivate varieties of grape Kallmet, beans with the same name and the large grain olive that is mentioned in the agricultural and scientific literature. In Kallmet have been built cultural monuments like the church of Saint Eufemia belonging to the XII century. It is a holy place visited by people of all regions. This church is part of the list of churches with special support by government.

The Municipality of Kallmet is known as a an important historical, cultural and religious center.



HISTORIA - HISTORY

Në fshatin Mërqi të komunës Kallmet, me 14 Janar 1703 u mbajt “Kuvendi i Arbërit” në Kishën e Shën Gjonit, me përkrahjen e drejtpërdrejtë të Papa Klementit XI– Albani. Ky Kuvend ishte më i rëndësishmi që zhvillohej në Shqipëri pas Kuvendit të Beslidhjes së Skendërbeut në Lezhë dhe kishte si qëllim bashkimin e shqiptarëve dhe ndaljen e islamizimit të Shqipërisë nga pushtuesit osmanë. Ky Kuvend ka një rëndësi të madhe edhe për historinë e gjuhës shqipe, sepse vendimet e këtij Kuvendi u botuan edhe këtë gjuhë, përveç latinishtes.

Kallmeti ka qenë trevë e kuvendeve dhe e veprimtarive patriotike për zonen veriore. Kujtojmë : nisjen e Lezhjanëve për mbrojtjen e Hotit e Grudës kundër malazezëve në prill 1880. Këtu kanë ardhur Ded Gjon Luli e Bajram Curri.



Papa Klementi XI – Albani
Pope Clement XI - Albani

In the village called Merqi of Municipality of Kallmet was held the assembly of Arber at the church of Saint John with the out right support of Pope Clement XI-Albani. This was the most important assembly taking place in Albania, after the assembly of “Beslidhja” (Binding of besa) of Skenderbeu in Lezhe and aimed the unification of the Albanians and the stopping of the Islamism brought by the ottoman invaders. This assembly has always had a great importance when it comes for the Albanian language because that’s decisions were published even in Albanian language besides the latin.

Kallmet has always been the region of the assemblies and patriotic activities of the whole northern area. Worth mentioning : the departure of people of Lezha for the protection of Hot and Grude, against Montenegrins in April 1880. Important figures like Ded Gjon Luli and Bajram Curri have been to visit Kallmet.



Emblema e 300 vjetorit
te Kuvendit te Arberit
The emblem of the 300th
anniversary of Assembly
of Arber

Në ditët e para të tetorit 1911 krerët e 12 Bajraqeve të Mirditës mbajtën një Kuvend në Kallmet nën kujdesin e Abatit Preng Doçi, ku u vendos që të mos u bindeshin autoriteteve osmane, të hiqej Kajmekami, të largohen trupat osmane, të njihen Preng Bibë Doda e Preng Doçi si të parët e vendit.

Gjithashtu me 4 Maj 1913 në Kallmet u mbajt një kuvend tjetër ku morën pjesë : përfaqësues nga 12 Bajrakët e Mirditës, përfaqësues nga Malesia e Madhe, përfaqësues nga Bregu i Matës, Lezha dhe Zadrima, Puka dhe nga Kurbin.

Në këtë kuvend u vendos: Lidhja e besës kundër pushtuesve malazet për të çliruar Shkodrën dhe viset veriore.

Kallmetorët kanë luftuar për liri dhe pavarësi. E rëndësishme është lufta në Zallin e përroit të Rraboshtes me 18 Maj 1912 kundër ushtrisë turke ku mbeten të vrarë rreth 35 ushtarë osmanë. Dhanë jetën kallmetorët: Pjetër Ll. Ndoj, Lazër Pata, Gjon Koleci dhe Prend Mapreçi të cilët janë shpallur dëshmorë të pavarësisë. Gjatë luftës Nacionalçlirimtare kallmetorët u rreshtuan me brigaden 24 sulmuese.

At the first days of October 1911, heads of 12 administrative divisions of Mirdita, held an assembly in Kallmet under the organization of Abat Preng Doci decided not to obey to the ottoman authorities, to keep away all the troops and Preng Bib Doda and Preng Doci be recognized as the country's first.

Also on 4th May 1913 in Kallmet another assembly was held where participated: representatives from 12 administrative divisions of Mirdita, representatives from Malesia e Madhe, representatives from Mat river bank, Lezha and Zadrima, representatives from Puka, representatives from Kurbin.

In this assembly it was decided: The binding of besa against Montenegrins invaders to rescue Shkoder and northern areas.

People of Kallmet have always fought for freedom and independence. Worth mentioning the war in the grave of stream of Rraboshta, in 18th May 1912 against the ottoman army about 35 soldiers were killed. There died : Pjetër Ll. Ndoj, Lazer Pata, Gjon Koleci, dhe Prend Mapreçi who are declared martyrs of independence. During the national liberation war people of Kallmet joined the 24th attacker brigade.

MONUMENTET E KULTURES - CULTURAL MONUMENTS

Saint Eufemia Church

Kisha Shen Eufemia



Koleci Spring

Kroi i Kolecit



Old Mill

Mulli i vjeter



Old Gjon

Ura Plak Gjon



Kallmeti shquhet si një qendër e rëndësishme historike, kulturore dhe fetare. Në Kallmet janë ngritur monumente të kultures si Kisha e Eufemisë e shekullit 13-të. Gjithashtu në Mërqi ndodhet kisha e Shën Gjorit , ku u mbajt me 14 Janar 1703 Kuvendi i Arbërit. Objekte të tjera të vlerësuara nga Komuna Kallmet si monumente kulturore dhe turistike janë: Qendra Ipeshkvnore, Mullinjtë e vjetër, Kroji i Kolecit, Ura Plak Gjon, Kisha e Zemrës së Krishtit , Kisha e Shën Gjinit etj.

Kallmeti is known as an important historical, cultural and religious center. In Kallmet there are cultural monuments like the church of Saint Eufemia belonging to XIII Century. Moreover, also in Merqi there is the church of Saint John where was held the assembly of Arber in 4th January . More objects evaluated by Kallmet Municipality as cultural and touristic monuments are: Episcopal Center, The old mills, Spring of Koleci, The old Gjon Bridge, The Heart of Jesus Church, Saint Jin Church etc.

KISHA SHEN EUFEMIA - SAINT EUFEMIA CHURCH

Kisha e Shën Eufemisë përmendet për herë të parë në një dokument të vitit 1343, ku Stefan Dushani e rendit në mes të kishave që i jepen Krujës. Po ashtu, në letrën që, papa Innocenti VII, i drejton nga Roma, me 12 nëntor 1404, ipeshkvit të Lezhës, Andrea, i jep atij të drejtën të gëzojë edhe të ardhurat e kishës famullitare të Kallmetit, Shën Eufemisë. Pas pushtimit të Lezhës nga turqit, në vitin 1478, shihet se ipeshkvi i Lezhës nuk qëndron më në qytet, por është zhvendosur në Kallmet.

Rreth dy shekuj më vonë, në vitin 1629, ipeshkvi i Lezhës, Benedikt Orsini, e rendit “Shën Eufeminë” e Kallmetit, në listën e kishave të dioqezës së Lezhës. Njëkohësisht ajo përmendet edhe në letrën e ipeshkvit të Sapës, Frang Bardhit, me 8 shkurt 1637 dhe rreth dy muaj më vonë, përsëri në një letër tjetër të po këtij ipeshkvi, me 28 maj 1637. Emri i kishës gjendet sot i shndërruar nga banorët në “Kisha e Shën Misë”.



Saint Eufemia Church is firstly mentioned in a document in 1343 where Stephan Dushani lists it amongst the churches given to Kruje. Furthermore, in the letter that Pope Innocenti VII directs from Rome in 12th November 1404 to Andrea, the Bishop of Lezha and gives him the right to enjoy even the outcomes of the parish church of Kallmet, Saint Eufemia. After

the invasion of Lezha by ottomans in 1478, the bishop of Lezha left Lezha for Kallmet.

Around two centuries later in 1629 the bishop of Lezha, Benedikt Orsini lists our church in the list of the churches of Diocese of Lezha. At the same time, it is mentioned even in the letter of Bishop of Sapes Frang Bardhi, 8th February 1637 and around two months later, once again in another letter of the same bishop in 28th May 1637. The name of the church is modified by inhabitants of Kallmet in “Kisha e Shën Misë”.



Amfiteatri i Kishes Shën
Eufemia
Amphitheater of Church
Saint Eufemia



**Peligrinazh të Kisha e
Shën Eufemisë**
*Pilgrimage to Saint
Eufemia Church*

Kisha Shën Eufemia ndodhet në fshatin Kallmet, në një lartësi prej 373 metrash, në anën perëndimore të një shkëmbi natyror, me përbërje gëlqerore. Nga vendndodhja e kishës mund të vështrohet e gjithë fusha e Drinit të Lezhës deri në Malin e Zefjanës, në Bushat, mali i Taraboshit, Kalaja dhe qyteti i Shkodrës.

Pranë kishës, nga shkëmbi gëlqeror rrjedh një burim uji i bollshëm, i cili është futur në brendësinë dhe në oborrin e kishës pasi shihet si ujë pastrues dhe bekues nga besimtarët. Kisha nuk ka absidë, por në vend të saj, një shkëmb i gjallë është përfshirë në brendësinë e kishës në të cilin është gdhendur skulptura e Shën Eufemisë nga skulptori Tonin Prendi.

The Saint Eufemia Church is located in Kallmet at height of 373 m , on the westside of a natural rock composed of limestone. From that point of its location, the whole fields of Drin of Lezhe can be seen up to Zefian Mountain in Bushat, the mountain of Tarabosh, the castle and the city of Shkoder.

Near the church from the limestone rock derives an abundant water source, inside and out of the church , and it is considered by the believers as purifier, and blessed water. The church doesn't have apses but instead of that, a big rock is located inside on which it is inscribed the sculputure os Saint Eufemia by the sculptor Tonin Prendi.

KISHA E SHEN GJON KRYEPREMIT- THE CHURCH OF SAINT JOHN

Kisha e Shën Gjon Kryepremi apo Kisha e Arbërit përmendet për herë të parë në relacionin B.Orsini, në vitin 1629. Kjo kishë ka një rëndësi të veçantë për historinë e dioqezës së Lezhës dhe më gjerë për kishën katolike shqiptare. Këtu, në vitin 1703, është mbajtur "Kuvendi i Arbërit", i drejtuar nga papa, me origjinë shqiptare, Klementi XI. Kisha duhet të jetë rindërtuar në fillim të shekullit XX, nën përkujdesjen austriake. Restaurimi i kishës në formën që ruhet sot është kryer në vitin 1996.

Në anën jugperëndimore të kishës është lënë një pjesë muri e pa suvatuar për të na kujtuar hershmërinë e saj.

Kisha ka katër dritare të ngushta, në anët veriore dhe jugore. Në pjesën ballore të kishës, hyrja kryesore është organizuar me dy dyer me arkada të bukura prej guri të gdhendur. Sipas traditës gojore të banorëve, njëra prej portave është përdorur për burrat dhe tjetra për gratë.



Kisha e Arbërit para rikonstruksionit.
The church of Arber before reconstruction.

The church of Saint of John or otherwise the church of Arber it is mentioned for the first time in the records of B.Orsini in 1629. This church has a great importance in the history of the diocese of Lezha, and further for the Albanian catholic church because here in 1703 was held the Assembly of Arber directed by the Pope Clementi XI of an Albanian origin. The church should have been rebuilt at the beginning of XX century, under the austrian auspices. The restauration of the church in the form that retains today is performed in 1996.

In the southwestern side of the church, there is a part of the hall left without being completed to remind us of its ancientness. The church has 4 close windows in the northern and southern side. In the front side, the main entrance of the church is organized with two doors with beautiful arcades of carved stone. According to oral tradition of the inhabitants one of the gates has been used by men the other by women.



Kisha e Shën Gjoni Kryepremi-
Arberit.
The Church of Saint John-Arber

FIGURA TE SHQUARA HISTORIKE

Në Kallmet janë lindur apo jetuar figura të shquara siç janë :

- Frang Bardhi (1606 - 1643) ipeshkv, shkrimtar, leksikograf, folklorist dhe etnograf. Autori i tretë i rëndësishëm i letërsisë së vjetër shqiptare. U lind në Kallmet në 1606 në një familje atdhetare. Ishte shkruesi i parë i një fjalori për gjuhën shqipe i cili ka rreth 5000 fjalë të përkthyer nga latinishtja në shqip. Ishte leksikografi i parë shqiptar. Veprat e tij kryesore janë : Apologjia e Skënderbeut (1636), Fjalori latinisht-shqip, Parathënia e Fjalorit të Frang Bardhit (1606-1643), (Dictionarum latino-Epiroticum) në vitin 1635.
- Imzot Luigj Bumçi u lind në Shkodër më 6 nëntor 1872 dhe vdiq më 1 mars 1945. Ishte peshkop i Kishës Katolike dhe diplomat shqiptar. U emërua peshkop i Lezhës më 11 shtator 1911 nga Papa Pius X, ai transferohet në Kallmet të Lezhës, ku ndërtoi kishën konkatedrale “Zemra e Krishtit”. Në vitin 1919, ai kryeson delegacionin e qeverisë shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris, ku mbajti një fjalim të rëndësishëm. Ishtë pjesmarrës në Kongresin e Lushnjës ku u zgjodh si një nga kater anëtarët e Këshillit të Lartë të Shqipërisë.
- Famullitari dom Dodë Koleci u lind në Kallmet në mes të shekullit XIX dhe vdiq në Ndërfanë të Mirditës, më 17 shkurt 1915. Ai ka shërbyer në hierarkinë kishtare prej afër 40 vjet, si famullitar në Orosh të Mirditës, Blinisht, Kaçinar, Mnelë e së fundi kohën më të gjatë prej 21 vjetësh e kaloi si famullitar në Ndërfanë, derisa vdiq. Ka qenë atdhetar dhe shkrimtar. Ka punuar për Gramatikën e parë gënishte të vitit 1901 dhe Fjalorin e shoqërisë “Bashkimi”.



Frang Bardhi



Imzot Luigj Bumçi

HISTORICAL FIGURES



Apologjia e Skenderbeut



Aqif Pashë Elbasan dhe Luigj Bumci

In Kallmet have born or lived famous wellknown figures like:

- Frang Bardhi (1606—1643) bishop, writer, lexicographer, folklorist and ethnographer. The third important author of the old Albanian literature. He was born in Kallmet in 1606 in a family with high patriotic principles. He was the first to write a dictionary for the Albanian language, with 5000 words translated from Latin to Albanian. He was the first Albanian lexicographer. His masterpieces are: The Apology of Scanderbeg (1636), Latin-Albanian dictionary, Introduction of Frang Bardhi's dictionary (1606–1643) (Dictionarium latino-epiroticum) in 1635.
- Monsignor Luigj Bumci was born in Shkoder on 6th November 1872 and died in 1st March 1945. He was bishop of the Catholic Church and Albanian diplomats (diplomat). He was named bishop of Lezha on 11th September 1911 by Pope Pius X and then he gets transferred in Kallmet of Lezha, where he built the cathedral church "Heart of Jesus" for all the people who have faith and believed in God. In 1919 he headed the delegation of the Albanian government in the Peace Conference in Paris, where he held a powerful speech. He participated in the Congress of Lushnje where he was elected as one of the four members of the High Council of Albania.
- The vicar dom Dode Koleci was born in Kallmet in mid XIXth century and died in Nderfane of Mirdite on 17th February 1915. He served to the church hierarchy for around 40 years as vicar in Orosh of Mirdite, Blinisht, Kcinr, Mnele and finally he spent the long time of 21 years as vicar in Nderfane until he died. He was patriotic and writer, he worked for the first Gheg Grammar of 1901 and for the dictionary of the "Union Society".

FIGURA TE SHQUARA HISTORIKE

- Dom Prend Suli u lind më 23 Shkurt të vitit 1873 në Kallmet. Ishte prift, dijetar, etnolog, folklorist i njohur, autor i shumë shkrimeve në revistat kulturore e fetare të kohës. Vdiq më 5 Maj 1943 në Mnel. Ishte anëtar i shoqërisë “Bashkimi”. Eshtrat e tij prehen në varrezat e Kallmetit të Vogël.
- Dom Gjergj Koleci, vella i dom Dod Kolecit, u lind në 1868 në Kallmet. Ishte prift dhe atdhetar i shquar. Edhe ai si vella i tij ishte pjesë e Shoqërisë Bashkimi, ku ishte aktiv me shkrime të ndryshme në gazetat kulturore dhe fetare. Ishte ipeshkëv i Sapës. Vdiq në vitin 1928.
- Kolin Hil Gjoka u lind më 19 Tetor 1966 në Ishull Shengjin nga prindër kallmetor, Hil Dod Gjoka dhe Dila Zef Gjoka, që u vendosen në Ishull Shengjin në vitet 50. Mbaroi shkollën e mesme të përgjithshme “Hydajet Lezha” në Lezhe 1981-1985. Kreu studimet e larta në Universitetin e Tiranës ku u diplomua për Matematikë 1985-1990. Në vitin 1990 fillon punë si pedagog në Universitetin e Shkodrës, në atë kohe bëhet pjesë e lëvizjes demokratike. Ishte anëtar i PD-së që nga 1991 ndërsa në vitin 1995 zgjidhet kryetar i forumit rinor të PD-së Shkodër. Në vitin 1995 specializohet në Universitetin e Firencës në kuader të programit TEMPUS. Në vitet 1996—1997 u zgjodh Deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe ishte kandidat për deputet në vitin 2001. Vdiq me 1 Shkurt 2002 pas një sëmundje të rëndë. Për kontribut të veçantë në lëvizjen studentore në Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër me dekret nr. 1436 datë 29.03.1996 të Presidentit Sali Berisha ai dekorohet me medaljen e “Trimërisë”. Këshilli i komunës Kallmet ka shpallur “QYTETAR NDERI” Kolin Gjokën pas vdekjes me motivacionin “Për kontribut të shquar intelektual në fushën e arsimit, shkencës dhe zhvillimeve demokratike në Shqipëri nga viti 1990 deri në vitin 2001”. Gjithashtu me 6 Mars 2006 Këshilli i Bashkisë Lezhë i dha emrin shkollës profesionale “Kolin Gjoka”.



Don Prend Suli




Kolin Gjoka

HISTORICAL FIGURES



Shoqëria e alfabetit shqip "Bashkimi"
themeluar nga priftitit jezuit në Shkoder në vitin 1899



Tituj për Kolin Gjokën

- Dom Prend Suli was born on 23 th February 1873 in Kallmet. He was priest, scholar, ethnologist, famous folklorist, the author of many writings in cultural and religious magazines of that time. He died on 5th May 1943 in Mnel. He was member of Union Society. He is buried in the cemetery of Little Kallmet.
- Dom Gjergj Koleci, brother of dom Dod Koleci, was born in 1868 in Kallmet. He was a priest and a wellknown patriotic. As his brother he was part of Union Society , where he was active with several writings in cultural and religious magazines. He was bishop of Sape. He died in 1928.
- Kolin Gjoka was born on 19th October 1966 in Ishull Shengjin by parents from Kallmet , Hile Dod Gjoka and Dila Zef Gjoka, that settled in the Ishull Shengjin in 50s. He finished highschool “Hydajet Lezha” in Lezhe in 1981 - 1985. Then he followed the university of Math in Tirana and graduated in 1985-1990. In 1990 he started working of professor in University of Shkoder and at that time he became member of the democratic movement. He was a member of Democratic party from 1991, while 1995 he was elected head of youth forum of Democratic Party in Shkoder. In 1995 he specialized in University of Firence on the program of TEMPUS. In 1996 he was elected Deputee of Assembly of Albania and was a condidat for a deputee in 2001. He died on 1st February 2002 from a severe disease. For his special attribute on the students movements in the University of Shkoder “Luigj Gurakuqi” and from the 1436 decree nr od 29.03.1996 he was he was honoured with medal of BRAVERY. The council of Kallmet Municipality has declared him honorary citizen after death for “Special intellectual attribute in the field of education, science and democratic developments in Albania from 1990 up to 2001”. Also on 6th March 2006, the council of Municipality of Lezhe gave the name of Kolin Gjoka to the professional school of Lezhe.

KALLMETI SI QENDER KATOLIKE - KALLMET AS AN CATHOLIC CENTER

Fshatrat e komunës Kallmet janë shquar si qendra të rëndësishme katolike për qarkun e Lezhës. Kjo vertetohet nga kishat që kanë mbërritur deri në ditët e sotme siç janë :

- Kisha e Shën Eufemisë
- Kisha e Kuvendit të Arbërit
- Kisha e Shën Gjinit
- Kisha “Zemra e Krishtit”
- Kisha e Kastenjotit

Pas rënies së Lezhës në duart e osmanëve qendra ipeshkvnore e Lezhës ka qenë kryesisht në Mërqi dhe Kallmet. Nga viti 1847, kur u vendosën në Kallmet ipeshkvijet që kanë jetuar ketu janë :

- ◆ Imzot Pali II Dodmasej
- ◆ Imzot Françesku Malczynski
- ◆ Imzot Leonard Deda
- ◆ Imzot Luigj Bumçi
- ◆ Imzot Nikoll Troshani



**Stema e Dioqezes se
Lezhes**

*The emblem of Diocese
of Lezha*

The villages of Kallmet Municipality have always been distinguished as important catholic centers of Lezha district. This is testified by the churches that still exist nowadays like:

- Church of Saint Eufemia
- Church of Assembly of Arber
- Church of Saint Jin.
- Church “Heart of Jesus Christ”
- Church of Kastenjoti

After the fall of Lezha in the hands of the ottomans, the bishop centre was mainly in Merqi and Kallmet. In 1847 when they moved, bishops that lived here are:

- ◆ Imzot Pali II Dodmasej
- ◆ Imzot Françesku Malczynski
- ◆ Imzot Leonard Deda
- ◆ Imzot Luigj Bumçi
- ◆ Imzot Nikoll Troshani

VESHJA TRADICIONALE - TRADITIONAL WEARING

Veshja e grave dhe vajzave kallmetore është veshje e veçantë që ndryshon plotësisht nga veshjet e krahinave që e rrethojnë.

Të veshja kallmetore mbizotëron e bardha, e quajtur edhe si vazhduese e veshjes ilire.

Ndërsa veshja popullore e burrit kallmetor, që nga kohët e vjetra e deri në ditët e sotme, ka ngjashmëri me veshjen e burrit të trevave veriore të vendit tonë.

Gjithashtu në komunën Kallmet ka edhe gra me veshje mirditore dhe zadrimore. Kjo ngaqë kallmetorët janë martuar me gra të këtyre krahinave.



Vitore Koleci

The traditional wearing of women and girls of Kallmet is very special completely different from that of other regions around. In our traditional costumes dominates the white colour, considered as sequential of Illyrian dressing.

While traditional costume of men from Kallmet old times, up to now has many things in common with that of the northern regions of our country.

Also in Kallmet Municipality you can find women keeping the tradition of Mirdite and Zadrime, this because men of Kallmet have married women of these regions.



Brezi — Sash



Perparsja- Apron



Veshja e burrit dhe gruas kallmetore
Wearing of the man and woman



Nusja kallmetore
Bride



Veshja e gruas dhe nuses kallmetore.
Wearing of woman and bride.

GRUPET ARTISTIKE - ARTISTIC GROUPS

Banorët e komunës Kallmet kanë treguar se janë popull artdashës. Ato kanë dhënë ndihmesën e tyre në kompletimin e ansamblit artistik të rrethit të Lezhës në zhanërat e ndryshme ku mund të përmendim : këngëtarët Drande Gega , Vitore Koleci, Gjyste Paloka, Gjyste Luigji, Drande Preçi, Pjetër Haberi; recituesin Stef Haberi etj. Kishte dhe një grup vallëtarësh që kompletinin kuadrin artistik të ansamblit të Lezhës që pati dhe suksese kombëtare.



Pamje të grupeve artistike të Kallmetit
Pictures of artistic groups of Kallmet



Stef Haberi



Drande Gega dhe Pjeter Haberi




Drande Gega

Residents of Kallmet Municipality have shown that they are fans people who love the art. Moreover they have helped a lot in completing the artistic Ensemble of Lezha, in different genres such as: In singing: Drande Gega, Vitore Koleci, Gjyste Paloka, Gjyste Luigji, Drande Preci, Pjeter Haberi, in recital: Stef Haberi etc.

But there used to be a group of dancers who completed the artistic level of Esemble of Lezha that had a great national success .

ARSIMI - EDUCATION

Kallmeti është një zonë me histori në fushën e arsimit. Shkolla e parë shqipe në Kallmet u hap që prej vitit 1902 me rreth 20 nxënës, e cila është një nga shkollat e para të veriut të Shqipërisë. Në këtë shkollë jepnin mësim dy murgesha kosovare: Sharlotë dhe Portogena Dema. Në vitin 1938 shkolla e Kallmetit numëronte rreth 38 nxënës. Edhe pse me një histori të hershme në hapjen e shkollës, përpara vitit 1944 pothuajse 80% e popullsisë ishte analfabete. Përgjatë viteve 1944- 1946 arsimit i detyruar u vendos si regjim edukimi në gjithë territorin e vendit. Pas çlirimit u hap shkolla fillore e detyruar në gusht 1946 me 168 nxënës. Më pas në vitin 1955 hapet shkolla 7 vjeçare e detyruar dhe vetëm në vitin 1989 hapet shkolla e mesme me dy degë kryesore në atë kohë, përkatësisht agrozooteknike dhe bujqësi. Popullsia e komunës Kallmet është karakterizuar si mjaft arsimdashëse në vite, edhe pse ndryshimet në sistemin e ekonomisë së tregut patën efektet e tyre edhe në sistemin arsimor si cilësinë e mësimdhënies, infrastrukturën e shkollave dhe kopshteve, nivelin e interesit për ndjekje të studimeve në pothuajse të gjithë vendin. Sot sistemi arsimor në komunë përfshin: sistemin parashkollor me gjithsej 5 kopshte me 90 fëmijë, sistemin e arsimit fillor me gjithsej 4 shkolla të ciklit të ulët me 327 nxënës, 2 shkolla 9 vjeçare me 215 nxënës dhe sistemin e arsimit të mesëm me një shkollë të mesme me 106 nxënës.



Shkolla ku kanë dhënë mësim motrat Dema
The school where sisters Dema taught.

*Shkolla e Mesme Kallmet
High School of Kallmet*



*Shkolla 9 Vjecare Rraboshte
Secondary School of Rraboshte*



*Shkolla Filllore Kallmet I Vogel
Primary School of Little Kallmet*



Kallmeti is region with a history in education. The first albanian school in Kallmet was opened in 1902 with around 20 students, which one of the first schools of the North Albania. In this school taught two sisters from Kosovo, Sharlote and Portogena Dema. In 1938 the school of Kallmet counted around 38 students. Even the opening of the school before 1944 almost 80 % of population illiteral. During 1944-1946 compulsory education was established in all the territory and the first compulsory primary school was opened after the liberation on August 1946 with 168 students. Later in 1955 it opened the first elementary school and only in 1989 it was opened the first high school with it's two branches respectively agrozo-technical and agricultural. The population of Kallmet Municipality has always been mentioned for it's love for education, eventhrough economic changes influenced the education system in general the quality of teaching process the infrastructures of schools and kinder gartens the level of the interest of the followers of studies, in almost all the place. Nowaday the education system in Municipality includes: 5 kindergarten 's with 90 children, primary schools with 327 pupils, 2 schools with 215 students and the high school system with only one consisting of 106 students.

EKONOMIA - ECONOMY

Aktivitetet kryesore ekonomike të kësaj komune janë të përqëndruara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, me fokus vreshtarinë dhe pemtarinë. Komuna është e njohur për prodhimin e verës vendase të Kallmetit si dhe vajit të ullirit karakteristik të kësaj zone, duke ruajtur kështu një traditë që e trashëgon që përpara viteve '90.

Komuna ka nën administrim një sipërfaqe prej 4306 ha nga të cilat 1875 ha është tokë bujqësore dhe pjesa tjetër pyje dhe kullota. Ajo është e pasur në burime natyrore, historike dhe sidomos kulturore çka ndërton premisa të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë dhe agroturizmit.

Fshatrat e komunës janë të pasura me burime natyrore uji, me kullota dhe të mbuluara me ullinjë shekullorë. Të ndodhura thellë në rrëzë të malit këto fshatra kanë veçoritë dalluese lokale dhe larmi zhvillimi si pasojë e klimës. Kështu psh, fshati Mërqi është i përshtatshëm për kultivimin e perimeve, ndërsa Kallmeti e Rraboshta për vreshta dhe ullishte, por kultivohen dhe pemë të tjera.

Emigracioni i kallmetorëve jashtë shtetit që në fillim të viteve '90 ka dhënë frytet e veta në zhvillimin e komunës Kallmet. Kjo shihet në investimet që janë bërë në ndërtimin e shtëpive nga më të bukurat në të gjithë zomën, në hapjen e bizneseve të ndryshëm, në investime në bujqësi etj.



Pamje të shtëpive në Komunën Kallmet

Views of houses of Municipality



The main economic activities of this municipality derives in the field of agriculture and farming with the focus an vineyards,archards. Kallmet Municipality is known for production of local vine of Kallmet as well as the olive oil preserving in this way a whole tradition that it inherits before 90s.

The municipality administrates a surface of 4306 ha from which 1875 ha is agricultural land and the rest , forests and pastures. It's rich in natural sources important for the further development of agriculture and agro-tourism. The villages of the Municipality are rich in natural water sources with pastures and covered with age-long olive trees. Located at the foot of the mountain these villages have their characteristic local features and varieties of development as a result of the weather. For instance the village Merqi is suitable for the cultivation of vegetables while Kallmet and Rraboshte for vineyards and olive groves but it can be cultivated other plants as well.

The immigration of the inhabitants outside the country since the beginning of 90's has had its impact on the development of the Kallmet municipality. This is seen in the huge investments for the constructions of the most beautiful houses in the whole village in the opening of their different businesses, agricultural investments etc

BUJQESIA, BLEGTORIA DHE AGROBISNESI

Blegtoria dhe bujqësia përbëjnë elementët kryesorë në sektorin e zhvillimit ekonomik në komunën e Kallmetit. Si rezultat i kushteve natyrore të komunës, si një zonë fushore dhe kodrinore, është favorizuar ndjeshëm rritja e bagëtive të imta dhe shtimi i gjedhit. Komuna e Kallmetit shquhet për cilësinë e lartë të produkteve me origjinë shtazore, kryesisht ndikuar nga prania e kullotave mjaft të mira si në zonën fushore ashtu dhe në atë malore. Po ashtu në zonën e Kallmetit kultivohen gjerësisht edhe bletët. Zona e Kallmetit është e pasur në tokë bujqësore. Bujqësia ashtu si edhe blegtoria është një element i rëndësishëm dhe një potencial për zhvillimin ekonomik të kësaj komune. Prodhimet karakteristike të komunës së Kallmetit, Vera "Kallmet" prodhohet nga varieteti i rrushit me të njëjtin emër. Rrushi "Kallmet" shquhet për vlerat e larta vinifikuese, cilësi kjo që ka mundësuar njohjen dhe vlerësimin e cilësisë me medalje në mjaft konkurse si brenda dhe jashtë vendit. Vera e Kallmetit bën pjesë ndër kategoritë e verërave më cilësore sot në Shqipëri. Prodhimi i saj realizohet në kushte bashkëkohore teknologjike dhe në përputhje me standartet e kërkuara. Hapja e Kantinës së Verës "Kallmeti Sh.p.k" ka ndikuar në rikthimin e traditës së kultivimit të hardhisë më të njëjtin emër nga fermerët e zonës.



Kantina e verës "Kallmeti Shpk" - Vinery "Kallmet Ltd"

AGRICULTURE, FARMING AND AGROBUSINESS



Fabrika e vajit te ullirit "Kallmeti Shpk"

Olive oil factory "Kallmeti Ltd"

Farming and agriculture are the main elements in the sector of the economic development in Kallmet Municipality. As a result of the natural conditions of the village as an area dominated fields and hills, it has been highly favored the growth and breeding of cattles goats and sheeps. Kallmet Municipality is known for the high quality animal products affected by the pastures, in the plain areas as well as in the mountain inside. Moreover in the region of Kallmet are bred bees as well. The area is rich in soil. Agriculture as well as farming are two main activities affecting the economic development. Fruit trees characteristic products of Kallmet Municipality, vine of Kallmet produced by the variety of the grape with the same name Kallmet. The grape "Kallmet" is known for the high values , a quality that has made possible the recognition and the evaluation of the quality with medals in many competition both inside and outside the country. The vine "Kallmet" is one of the most qualitative vine nowadays in Albania. Its production is realized in contemporary technological conditions , in accordance with the standards required. The opening of this vinery "Kallmet Ltd" has influenced in the retrival of the old tradition of cultivation of grape vine with the same name by the formers of the area.

BUJQESIA, BLEGTORIA DHE AGROBISNESI

Kallmeti ka një traditë të njohur në kultivimin e ullirit. Vaji i ullirit “Kallmet” prodhohet nga ulliri tradicional i Kallmetit. Cilësia dhe përçindja e vajit të ullirit e prodhuar në këtë zonë është e lartë dhe për këtë arsye ky produkt është mjaft i kërkuar në tregjet rajonale e lokale. Prodhimi i mjaltit gjatë viteve të fundit ka patur rritje. Kjo falë pozicionit gjeografik të favorshëm të komunës. Mjalti është i një cilësie të lartë gjë që ka çuar në vlerësimin e tij me çmime të para në panairot e organizuara në qarkun e Lezhës dhe më gjerë. Prodhimi i perimeve ka një kontribut të rëndësishëm në prodhimin e përgjithshëm bujqësor në komunë. Fermerët e zonës arrijnë të prodhojnë në sajë të cilësisë së mirë të farës, prodhimtarisë së tokës, por dhe angazhimit të tyre të vazhdueshëm për përmirësimin e cilësisë së produkteve të tyre bio .



AGRICULTURE, FARMING AND AGROBUSINESS



Kallmet has an old tradition in the cultivation of the olive. The olive of Kallmet is produced by the traditional olive variety. The quality and the percentage of olive oil produced in this area is very high and that is the reason why this product is widely required in not only regional markets but further. The production of honey has had a considerable growth during the latest years because of rich pastures and the good geographic position of the Municipality. This honey is of a great quality that has resulted with first prizes in fairs and other competitions organized in whole district of Lezha and further. The production of vegetables pays an important contribution in the general agricultural production of the municipality. Farmers of the area achieve to produce by the high qualitative seed, fertility of soil and their continuous engagement for the improvement of the quality of their bio products.

TURIZMI - TOURISM

Pozita gjeografike e komunës favorizon ndjeshëm zhvillimin e turizmit në këtë zonë si pjesë integrale e zhvillimit të turizmit në rajon, duke i shërbyer këtij të fundit me pasurimin e vendeve dhe monumenteve natyrore e kulturore për vizitorët. Përveç kësaj ne ofrojmë veprimtari kulturore tradicionale, njohje me arkitekturën dhe ndërtimet tradicionale etj. Në këtë kontekst, komuna Kallmet mbetet një qendër e rëndësishme e turizmit në qarkun e Lezhës sidomos duke shtuar vlerën e atraksioneve turistike në sajë të dy vendeve me mjaft vlera dhe peshë historiko-kulturore: Kishës së Shën Eufemisë në fshatin Kallmet dhe Kishës së Shën Gjonit në fshatin Merqi (vendi u mbajt Kuvendi i Arbërit). Në vitet e fundit është ngritur “Kompleksi i Qendrës Famullitare”, i cili është një kompleks objektësh duke përfshirë shkollën, kopështin, qendren e rinisë, shtëpinë e murgeshave etj. Këto shërbime ndikojnë për formimin kulturor dhe edukimin fetar të fëmijëve dhe të të rinjve të zonës por dhe duke u kthyer në një qendër të rëndësishme aktiviteteve kulturore.

**Kopshiti Shën Eufemia
Saint Eufemia Kindergarten**



**Kisha Zemra e Krishtit
“Heart of Christ” Church**



**Shkolla Shën Eufemia
Saint Eufemia School**



The geographical condition of the municipality highly favors the development of tourism in this area as an integral part of the tourism development in the region the latter serves to the enrichment of places and cultural monuments for the visitors traditional activities getting to know the architecture and folk constructions etc. In this context, Kallmet Municipality remains a very important center of the tourism of Lezha district especially evaluating the touristic attractions of cultural - historical values of Church Saint Eufemia in village of Kallmet and the Church of Saint John in the village of Merqi. Otherwise known as the “Assembly of Arber”. During the latest years it has been built the complex center of the Parish of Kallmet including complex of buildings: school, kindergarten, a center for youth, the house of the sisters etc. This services and facilities influence the cultural background and the religious education of the children and the youth of the area as well as becoming an important center of cultural activities.

Objekte të tjera historike në komunën Kallmet janë :

- ◆ Ish qendra ipeshkvnore, qendër e rëndësishme e katolicizmit të qarkut Lezhë, në kohën kur Lezha ishte e pushtuar nga osmanët. Aty ka punuar dhe jetuar Imzot Luigj Bumçi, ipeshkëv i Lezhes, anetar i Këshillit të Lartë të Shqipërisë, përfaqësues i Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris dhe pjesmarrës në Kongresin e Lushnjës.
- ◆ Ura “Plak Gjon” është një nga urat e rrugës së kalldramate që ka kaluar përmes Zadrimes, rrugë e ndërtuar nga Jul Qezari në fillim të erës sonë si degë e rrugës Egnatia. Edhe sot disa prej urave të riparuar që ekzistojnë mbajnë akoma emrat e riparuesve si : Ura “Plak Gjon” (Plaku Gjon), Ura Vajgur, Ura e Shkinës (Shkie-Shkinë-Grua Malazeze), “Ura e Re”, Ura e “Marin Sumës” (Marin Suma ishte Ipezhkv i SAPËS në shek .XIII)

Other historical buildings in Kallmet are:

- The former episcopal center, very important for the Catholicism of the district of Lezha at the time when Lezha was invaded by the ottomans. There lived and worked Mons. Luigj Bumci, bishop of Lezha, member of High Council of Albania, representative of Albania in the Peace Conference of Paris and participant in the Congres of Lushnje.
- The bridge “Plak Gjon” (“Old John”) is one of bridges of the cobbled road that has passed through Zadrime, built by Jul Ceasar BC as a branch of the Egnatia road. Even today some of the repaireds bridges bear the name of the ones who repaired them.: the bridge Plak Gjon (Old John), Vajgur Bridg,e, the bridge of shkine(shki-shkine, a Montenegrin woman), the New Bridge, the bridge of Marin Sumes (Marin Sume,te first bishop of Sape at that time, it is about XIII century).

Ura Plak Gjon
Old John Bridge



TURIZMI - TOURISM

Kisha “Zemra e Krishtit” e ndërtuar nga Imzot Luigj Bumçi ipeshkvi i Lezhës në fillim të shekullit XX. Kjo kishë kishte funksionin e katedrales, pasi ipeshkvi jetonte në Kallmet që nga koha që Lezha kishte qenë e pushtuar nga osmanët. Kjo kishë u tentua të priset gjatë vitit 1967, por pastaj u kthye në një magazinë. Pas viteve '90 u rikonstruktua dhe sot vjen si një nga kishat më të bukura katolike në Shqipëri.



Kisha Zemra e Krishtit para kthimit ne magazine nga sistemi komunist-1967

The church “Heart of Christ” before being turned into a storehouse from the communist system 1967



The Church “Heart of Jesus Christ” built by Mns. Luigj Bumci, the bishop of Lezhe, in the beginning of XX century. This church functioned as a cathedral because the bishop lived in Kallmet since ottoman invasion. It endangered destruction but then it was turned into storehouse. This church was rikonstruted after 90s and nowadays it is considered as on of the most beautiful catholic churches in Albania.

Në fshatin Kallmet i Vogël, pranë rrugës që të çon në zonën malore të Ungrejt, mbi një kodër të butë, ndodhet kisha e Shën Gjinit. Një relacion i Frang Bardhit, i datës 10 prill të vitit 1641, e përmend kishën e Shën Gjinit si kishë-kapelë të Kallmetit.

Dy gurë me mbishkrime latine, që ruhen vetëm pjesërisht, janë ndërfutur si spoliene murature: njëri prej tyre, në hapsirën gjysmërrethore, në mes të arkitraut të derës së kishës dhe qemerit të saj, ndërsa tjetri në krahun e majte, pranë paturës së derës, në lartësi 1,50 m mbi sipërfaqen e tokës. Këto gurë duken se janë pjesë e një një gurri varri , ku shohim të gdhendur vitin 1836. Të hyrja e kishës ndodhet varri i don Prend Sullit.



Kisha e Shen Gjinit– Saint Jin Church



Mbishkrimet latine

Latin inscription

In the village Little Kallmet near the road that gets to Ungrejt, uphill, its located the church of Saint Gjin, sates from Frang Bardhi on 10th April 1641 regard the Church of Saint Jin as Church-hat of Kallmet.

Two stones with latin inscriptions, which are partially preserved are fused as spoliene one, in the semicircular space in the middle of tese door of the church, while the other one. In the left side, close to the door, in the height of 1.50 m up from the surface, it seems like a tombstone with the year 1836 carved on ti. At the entrance of the church is the tomb of Don Prend Suli.

TURIZMI - TOURISM

Gurra e Vroges— *The fountain of Vroge*



Në Kallmet ndodhen monumentet natyrore siç janë :

- ◆ Pylli i Kishës Shën Eufemia
- ◆ Shpella e Hutit
- ◆ Ulli mbi 1500 vjeçar
- ◆ Burgu i Hajdarit

In Kallmet there are natural monuments like:

- ◆ The forest of Saint Eufemia Church
- ◆ The cave of Hut
- ◆ Olive tree over 1500 Yers old.
- ◆ Haydar prison



Pylli i Kishës Shën Eufemia
The forest of Saint Eufemia Church



Ulli mbi 1500 vjeçar
Olive tree over 1500 Yers old



Burgu i Hajdarit-Haydar prison



Burgu i Hajdarit-Haydar prison

Në kuadër të zhvillimit të turizmit komuna parashikon realizimin e investimeve si më poshtë:

- ◆ Ndërtimi i Qendrës Muzeale të Kallmetit .
- ◆ Rikonstruksioni i Rrugës Qëndër Kallmet i Madh- Kisha “Zemra e Krishtit “.
- ◆ Rikonstruksion i Krojit të Kolecit .
- ◆ Rikonstruksion i Mullinjëve të Vjetër të Kallmetit .
- ◆ Rikonstruksion i Rrugës qendër Merqi- Kisha “Kuvendi Arbërit”.

In the framework of tourism development the Municipality provides the realization of the following investments:

- ◆ The construction of the museum center of Kallmet.
- ◆ Reconstruction of the road “ Center of Kallmet i Madh - The church of Heart of Christ”.
- ◆ Reconstruction of Koleci Spring.
- ◆ Reconstruction of the road the old mills of Kallmet.
- ◆ Reconstruction of the road Center Merqi - the church of the “Assembly of Arber”.



Kisha e Shën Eufemisë
The Church of Saint Eufemia

DEMOGRAFIA - DEMOGRAPHY

Historiku i vendosjes së banorëve në zonën e Kallmetit daton që prej shek. 6-8 es. Statistikat më të hershme demografike të komunës Kallmet janë ato të vitit 1671 ku rezultojnë 35 shtëpi me vetëm 350 banorë. Kjo e dhënë historike tregon për vendbanim dhe popullim të hershëm të zonës, por dhe për potencialet dhe mundësitë që ky vend ofronte. Ndryshimet demografike të dy dekadave të fundit ashtu si në të gjithë vendin, janë të pranishme dhe në këtë komunë. Pavarësisht se me një popullsi relativisht të vogël, komuna e Kallmetit ka pësuar luhata të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e numrit të popullsisë. Ky fenomen më i ndjeshëm ka qenë pas viteve '90. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në këtë proces lidhen me lëvizjen migratore të popullsisë drejt zonave më të urbanizuara si brenda rajonit të Lezhës ashtu dhe jashtë saj, me emigracionin kryesisht si pasojë e ndryshimit të sistemit pas viteve 1990, ku lëvizja e lirë, mundësoi largimin e mjaft njerëzve, kryesisht moshën e re. Nxitur nga investimet publike të realizuara përgjatë viteve të fundit në përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve publike, por dhe nxitjes dhe mbështetjes së zhvillimit rural kryesisht me fokus bujqësinë, si pemëtaria dhe vreshtaria, është vënë re se ka një tendencë në rënie të lëvizjes migratore si brenda vendit, por dhe jashtë tij.

The background of settlement of the inhabitants in the region of Kallmet dates back to 6-8 centuries. The earliest demographic statistics of Kallmet Municipality are those of 1671 where there resulted only 35 houses with 350 inhabitants. This historical data shows on the early settlement and population of the area as well as the opportunities that this region provided. Demographic changes just as in other areas are present even in this municipality, despite the fact that it has a relatively small population. Kallmet Municipality has undergone fluctuations that have influenced the number of population, this common phenomenon especially during and after 90's. The main factors affecting this process are related with the migratory movements towards the urban areas both inside and outside with the immigration mainly as a result of changes of the system after 1990's where the free movement of people brought their departure, especially the young generation, both inside and outside the national boundaries. Driven by the public investment for the purpose of the improvement of the infrastructure, during the latest years but that of the improvement of public services and the support of the rural development with the focus on agriculture, orchards, vineyards, it has been noticed that migratory movement tends to drop both inside and outside.

INVESTIMET PUBLIKE

Pas viteve '90 në Komunën Kallmet janë bërë investime të shumta në drejtim të zhvillimit të infrastrukturës rrugore, në ujësjellësa dhe sistem vaditjeje, në arsim, në shëndetësi etj, me qëllim zhvillimin e komunës dhe rritjes së mirëqenies së banorëve të saj.

Disa nga investimet që mund të përmendim janë :

- Sistemi i pompave për vaditje me ngritje mekanike.
- Ndërtimi i qendrës Shëndetësore në Kallmet dhe i ambulancave në fshatrat e tjerë.
- Rikonstruksioni i rrugëve lidhëse të fshatrave me superstradën.
- Rikonstruksion i qendrave të fshatrave të komunës me ndriçime publike.
- Rikonstruksioni i rrugës Lezhe-Kallmet –Vau Dejes
- Rikonstruksion i të gjithë shkollave të Komunës .
- Rikonstruksion i zyrave të komunës Kallmet dhe zyrës së Gjendjes Civile.
- Ndërtim i ujësjellësit të fshatit Mërqi
- Investime në Bujqësi, pyje dhe kullota
- Ndërtimi i rrugës Kallmet i Madh-Kisha Shën Eufemia.
- Rikonstruksion i rrugës qendër Rraboshtë - Rruga nacionale dytësore.



Zyra e Gjendjes Civile
Registrar Office


Rruga Rraboshte-Superstrade
Road Rraboshte- Highway



Stacioni i pompave te ujesjellesit Merqi
Pumps stacion of water supply Merqi



Rruga Kallmet– Superstrade
Road Kallmet—Highway



Rruga e Lezhe - Kallmet - Vau Dejes
Road Lezhe – Kallmet - Vau Dejes



Rruga Kallmet-Kisha Shen Eufemia

Road Kallmet- Church Saint Eufemia



Shkolla e mesme Kallmet

High School of Kallmet



Shkolla 9 Vjecare Rraboshte

Secondary Scholl of Rraboshte



Qender Kallmet i Madh

Center of Great Kallmet



Zyrat e Komunes Kallmet

Offices of Kallmet Municipality

After 90s in Kallmet Municipality have been made numerous investments in terms of the road infrastructure development, water supply, irrigation system, education etc aiming the development of municipality and the increase of the inhabitants welfare.

Some of the investments worth-mentoning are:

- The system of pumps for irrigation, built mechanically.
- The construction of the “Health Center” in Kallmet and of ambulances in other villages.
- Reconstruction of the roads connecting the village with highway.
- Reconstruction of the villages’s centers of municipality, providing public lighting.
- Reconstruction of the national road Lezhe—Kallmet-Vau Dejes.
- Reconstruction of all the schools of municipality of Kallmet.
- Reconstruction of the offices of Municipality and that of Registrar Office.
- Construction of a water providing system of the village of Merqi.
- Investments in Agriculture, forest and pastures.
- Construction of road Great Kallmet - Church Saint Eufemia
- Reconstruction of the road Center Rraboshte – Secondary National road.

KALLMETI DHE KALLMETORËT NE SYRIN E PIKTORIT

"Mbledhës shqiptarë të ullirit", titullohet tabloja e njërit prej piktorëve më të shquar amerikanë të të gjitha kohërave, John Singer Sargent (1856-1925). Tablo e realizuar direkt nga natyra me 1909 dhe ruhet në Galerinë e Artit të Mançesterit. Peizazh mesdhetar me mbledhës shqiptarë të ullinjve gjatë punës. Në të majtë, pemë të mëdha ullinjsh të vjetër, poshtë të cilave gra

me veshje kallmetore që janë përkulur duke mbledhur ullinj për tokë. Në sfond djathtas, një figurë qëndron në këmbë me një shkop të gjatë që arrin deri lart te degët e ullirit. Dielli përndrit qiellin mbi ta dhe drita e tij bie përmes kurorës së dendur të pemëve". Dhe ajo që mund të thuhet me siguri janë veshjet e "mbledhësve shqiptarë të ullinjve" me veshjen karakteristike të grave kallmetore, e cila është një veshje unikale në të gjithë Veriun. Prandaj mund të arrihet lehtë në konkluzionin se Sargenti në udhëtimin e tij të vitit 1909 është ndalë në Shqipërinë e veriut, në fshatin Kallmet, ku ka realizuar tablonë.




"Albanian Olive Gatherers " is titled the picture of one of the most famous american painters of all times John Singer Sargent (1856—1925). A picture derived directly from nature in 1909 and that is preserved in the Gallery of Art in Manchester. Mediterranean landscape with Albanian olive gatherers during their work. On the left, by olive trees down of which woman of

Kallmet, collecting olives on the ground. On the right, a figure standing with a longstick arriving up to the branches of tree. The sun shining in the sky and its light falls through the dense crown of trees. And what can be said is the wearing of collectors above characteristic of woman of Kallmet, a unique wearing of the whole North. Therefore it can be concluded, Sargenti in his trip of 1909 has stopped for a while in village of Kallmet where completed his picture.

KALLMETI AND ITS INHABITANTS IN THE EYE OF THE PAINTER



Gruaja Kallmetore
Woman of Kallmet



Peisazh: Fragment nga Kallmeti
View: Fragment from Kallmet



Piktura të realizuara nga Pashk Pervathi
Paintings by Pashk Pervathi

VIZIONI PER TE ARDHMEN

Kallmeti, vendi i verës dhe ullishtave në rajonin e Lezhës. Një nyje ndërlidhëse dhe qendër zhvillimi mes rajonit Lezhë dhe Shkodër duke ndërthurur zhvillimin tradicional të vreshtave dhe ullishtave dhe teknologjitë bashkëkohore drejt zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë. Këtu komuniteti jeton në harmoni me perspektivën kulturore dhe atë fetare nëpërmjet ruajtjes dhe pasurimit të vazhdueshëm të vlerave të bartura në shekuj dhe frymëzimit me to për edukimin e gjeneratës së re.

Kallmeti, aty ku pasuritë e mjedisit të shëndetshëm natyror ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të zonës duke e shndërruar atë në nyje avangard të shfrytëzimit dhe integritit të potencialeve natyrore, bujqësore dhe blegtorale.

Kallmeti, një vend arsimdashës, i cili qeveriset me qytetarët dhe për mirëqënien e jetesës së qytetarëve, ku transparenca dhe informimi i vazhdueshëm e bëjnë këtë qeverisje të hapur, nga ku burojnë lidhjet e forta dhe mbështetja e komunitetit tek njëri tjetri i jep jetë e kuptim identitetit të kallmetorit.

Një vend ku qytetarët dhe fëmijët e tyre të mund të jetojnë, punojnë, zhvillojnë veten përmes arsimimit, punës dhe ndërveprimit social, të gëzojnë shëndet të mirë dhe një mjedis të favorshëm natyror dhe kulturor.



VISION FOR THE FUTURE




Kallmeti, the place of vine and olive plantations, in the region of Lezhe, is a hub and a main development center between regions of Lezhe and Shkoder and a main liaison between them, combining the traditional development of vineyards and olive groves and modern technologies towards a sustainable development of agriculture where the local community lives in the harmony with culture and religion preserving and enriching those values held in centuries and get inspired by them to raise new generations.

Kallmeti, the place where the healthy natural environment provides a sustainable economic development of the area by transforming it into a node vanguard of exploitation and integration of natural agriculture and livestock.

Kallmeti, the center of education lovers which is governed along with the citizens and for the improvement of their living and welfare where the transparency and continuous information make this an open governance from where derive strong ties and the community support gives life and sense to the identity of Kallmet.

A place where the citizens and their children can live, work and improve themselves through education, work and social interaction, be healthy in an appropriate natural and cultural environment.

An aerial photograph of a valley. In the center, there is a large, calm lake. Surrounding the lake and extending into the distance are patches of green and brown fields, interspersed with small clusters of buildings, likely a village or town. The foreground shows a steep, green hillside with some trees. The background is hazy, suggesting a distant town or city. The image is framed by a blue border at the top and bottom, with a yellow horizontal bar separating the top and bottom blue sections.

Literatura e konsultuar:

1. **“Kuvendi i Arberit” 1703 - Konferenca Ipeshkvnore Shqiptare Tirane, Prishtine 2003.**
2. **“Monumente Historike të Kultit të Krishtere në Dioqezen e Lezhes”, Dioqeza e Lezhes, Lezhe 2009.**
3. **“Antologji Historike”, Gjet Ndoj, Tirane 2009**
4. **“Shenime historike per disa treva te Lezhes”, Mark Pema, 2007.**
5. **“Të njohëm mos me të harrue, Kolin Gjokës në 40-vjetorin e lindjes“ , Martin Dedaj, Lezhë, Tetor 2006**